

Broshurë teknike

DUROFLOOR-BI

Material epoksid pa ngjyrë me 2 përbërës për imprenjime

Përshkrimi

DUROFLOOR-BI është një sistem epoksid pa ngjyrë, me 2 përbërës dhe me tretës. Për shkak të viskozitetit të ulët të tij dhe fluiditetit të madh, ai mund të depërtojë thellë në nënshtresë dhe i mbush porët dhe kapilarët. Sipërfaqet e ngopura bëhen të qëndrueshme dhe të forta, rezistente ndaj gërryerjes, ngricës dhe kimikateve, në veçanti ndaj papastërtive, produkteve të naftës dhe ndaj vajrave mineralë.

Ai klasifikohet si SR-B2,0 sipas standardit EN13813.

Fushat e përdorimit

DUROFLOOR-BI përdoret për imprenjimin e nënshtresave me bazë çimentoje, p.sh. betoni i ri dhe i vjetër, të llaçit ose suvasë me çimento etj. Ai është i përshtatshëm për dyshemetë në parkingje, magazina, laboratorë, mjedise industriale, pika karburanti, ofiçina makinash etj.

Ai përdoret gjithashtu si astar për shtresat epokside EPOXYCOAT, EPOXYCOAT-VSF dhe EPOXYCOAT-S.

Të dhënat teknike

Baza:	rrëshirë epokside me 2 përbërës
Ngjyra:	transparent
Viskoziteti:	45 mPa·s në +23°C
Densiteti (A+B):	0,92 kg/litër
Raporti i përzierjes (A:B):	100:29 sipas peshës
Koha e punueshmërisë:	rreth 10 orë në +20°C
Temperatura minimale e mpiksjes:	+8°C
Koha e shkeljes:	pas 24 orësh në +23°C
Shtresa pasuese:	pas 10-24 orësh në +23°C
Fortësia finale:	pas 7 ditësh në +23°C
Forca ngjitime:	> 3 N/mm ² (pika e thyerjes së betonit)
Rezistenca ndaj konsumimit EN 13892-4 (BCA):	≤ 50 µm, AR0.5

Pastrimi i veglave:

Veprat duhet të pastrohen plotësisht me tretësin SM-25 menjëherë pas përdorimit.

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtresa

Sipërfaqja e dyshemesë për shtrim duhet të jetë:

- E thatë dhe e qëndrueshme.
- Pa materiale që pengojnë ngjitjen, si p.sh. pluhuri, grimcat e lira, grasoja etj.
- E mbrojtur nga sulmi i lagështirës nga poshtë.

Gjithashtu, ajo duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

Cilësia e betonit: të paktën C20/25

Cilësia e llaçit të çimentos: përmbajtja e çimentos 350 kg/m³

Mosha: të paktën 28 ditë

Niveli i lagështirës: më pak se 4%

Në varësi të natyrës së nënshtresës, ajo duhet të përgatitet nëpërmjet fërkimit me furçë, gërryerjes, pastrimit me një fshesë me vakuum me fuqi të madhe thithëse etj.

2. Përzierja e përbërësve

Përbërësit A (rrëshira) dhe B (forcuesi) janë të paketuar në dy enë të ndara, të cilat kanë raportin e paracaktuar të përzierjes sipas peshës. Dy komponentët përzihen në një enë të pastër dhe të thatë – rekomandohet një kohë përzierjeje rreth 5 minuta me mikser me xhiro të ulëta (300 rpm.). Është e rëndësishme që përzierja të trazohet plotësisht pranë anëve dhe fundit të enës në mënyrë që të arrihet përhapja uniforme e forcuesit.

3. Përdorimi - Konsumi

DUROFLOOR-BI aplikohet me rul, me furçë ose me spërkatje në 1-2 duar (shtresa), sipas aftësisë thithëse të nënshtresës. Dora e dytë jepet 15 minuta pasi të jetë aplikuar dora e parë. Konsumi: 150-250 g/m²/shtresë.

DUROFLOOR-BI

DUROFLOOR-BI mund të aplikohet mbi betonin e ri (i hedhur rreth 3 ditë më përpara), sepse tharja nuk ka probleme. Ai mund të aplikohet gjithashtu mbi nënshtresa paksa të lagështa (niveli i lagështisë deri në 6%). Në të dyja rastet arrihet një thellësi e vogël imprenjimi.

Nëse kërkohet një thellësi imprenjimi rreth 5 mm brenda në beton, atëherë niveli i lagështirës duhet të jetë më i ulët se 3%.

Amballazhimi

DUROFLOOR-BI ofrohet në paketime (A+B) prej 4 kg dhe 10 kg, ku përbërësit A dhe B kanë një raport të fiksuar të peshës.

Magazinimi

Të paktën 12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në paketimin original të izoluar, në ambiente të mbrojtura nga lagështira dhe ekspozimi në dritën e diellit. Temperatura e rekomanduar e magazinimit është midis +5°C dhe +35°C.

Shënime

- Punueshmëria e materialeve epokside ndikohet nga temperatura e tyre. Temperatura ideale e përdorimit është midis +15°C dhe +25°C në mënyrë që produkti të jetë i lehtë për t'u përdorur dhe për t'u tharë, ashtu siç shpjegohet më lart. Temperatura e ambientit nën +15°C do të rrisë kohën e tharjes dhe temperatura mbi +30°C do të përshpejtojë kohën e tharjes. Gjatë dimrit rekomandohet një ngrohje paraprake e produktit, kurse në verë rekomandohet ruajtja e materialit në një vend të freskët përpara përdorimit.
- DUROFLOOR-BI përmban tretës. Në rast përdorimi në dhoma të mbyllura, duhet të merren masa për ajrosje të mirë.

- Thithshmëria jo uniforme e nënshtresës mund të shkaktojë një pamje jo uniforme të sipërfaqes pasi ajo të jetë imprenjuar.
- Ngjitja e shtresave pasuese mund të ndikohet ndjeshëm nga ndërhyrja e lagështirës ose papastërtive midis tyre.
- Shtresat epokside duhet të mbrohen nga lagështira për 4-6 orë pas aplikimit të tyre. Lagështira mund të zbardhë sipërfaqen dhe/ose ta bëjë ngjitëse. Ajo mund të çrregullojë mpiksien gjithashtu. Shtresat e zbehura ose ngjitëse në pjesë të ndryshme të sipërfaqes duhet të hiqen duke u gërryer ose duke u fërkuar dhe pastaj të shtrohen përsëri.
- Nëse një kohë më e gjatë se ajo e parashikuar ndodh midis aplikimeve të shtresave pasardhëse ose në rast se dyshemetë e vjetra do të shtrohen përsëri, sipërfaqja duhet të gërryhet dhe të pastrohet plotësisht përpara aplikimit të një shtrese të re.
- Pas ngurtësimit, DUROFLOOR-BI është totalisht e sigurt për shëndetin.
- Përpara përdorimit, lexoni këshillat e sigurisë të reguara në etiketën e produktit.

Përbërësit organikë të avullueshëm (VOC)

Sipas Direktivës 2004/42/KE (Shtojca II, tabela A), përmbajtja maksimale e lejuar e VOC-së për produktin e nënkategorisë "h", lloji SB është 750 g/l (2010) për produktin e gatshëm për përdorim. Produkti i gatshëm për përdorim DUROFLOOR-BI përmban maksimumi <750 g/l VOC.

DUROFLOOR-BI



ISOMAT S.A.
17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag Athanasios, Greece

08

EN 13813 SR-B2,0

Prajmer (astar)

DoP No.: DUROFLOOR-BI/1821-01

Reagimi ndaj zjarrit: NPD

Çlirimi i substancave gërryese: SR

Përshkueshmëria e ujit: NPD

Rezistenca ndaj konsumimit: NPD

Forca ngjitëse: B2,0

Rezistenca ndaj goditjes: NPD

Izolimi i zhurmës: NPD

Përthithja e zhurmës: NPD

Rezistenca termike: NPD

Rezistenca kimike: NPD

ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

Kilometri i 17të i Autostradës Selanik-Aj. Athanasiu 570 03

Tel. : +30 2310 576 002, Fax: +30 2310 576 029

www.isomat.al e-mail: support@isomat.eu